

25636

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJKATA E RRETHIT TIRANE
NR.25636 Akti

VENDIM
PER
REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK
Shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI"Sh.p.k

Ne Tirane, me 13.4. 2001, une gjyqtare *A. Capo* i Gjykates se Rrethit Tirane, mbasi studiova kerkesen dhe dokumentacionin perkates te paraqitur nga Administratori Z. AGRON PAPULI i Shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI"Sh.p.k per rregjistrimin e shoqerise, si person juridik,

KONSTATOVA:

Se ne baze te Aktit te Themelimit te neneshkruar nga ortaket :ARBEN PAPULI, AGRON PAPULI, MITRUSH CUMASHI, AGRON PECANI, SHOQERIA "MEDIA 6" sha perfaqesuar nga Drejtori Z.ALEKSANDER FRANGAJ dhe SHOQERIA "MARO" shpk perfaqesuar nga administratori Z.MARSEL SKENDO eshte vendosur themelimi i SHOQERISE "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" shpk, prandaj kerkon rregjistrimin si person juridik .

Shoqeria ka per objekt veprimtarie :shtypshkronje per shtypjen e revistave, librave, gazetave dhe botimeve te tjera te ndryshme, si dhe import – eksport materialesh shtypi etj..

Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 100.000 leke.

Kohezgjatja e Shoqerise eshte mbi 15 vjet

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, Rr. "Beqir Luga",Nr.3

ADMINISTRATORI i Shoqerise eshte Z.AGRON PAPULI..
Nga sa siper kerkesa eshte e drejte dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE:

Ne mbeshtetje te Ligjes Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr.7667 date28.01.1993 "Per regjistrin Tregtar".

V E N D O S A

Te regjistrohet person juridik: **Shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI"Sh.pk.**

Shoqeria ka per objekt veprimtarie :Shtypshkronje per shtypjen e revistave, librave, gazetave dhe botimeve te tjera te ndryshme, si dhe import-eksport materialesh shtypi etj.

Selia e shoqerise do te jete ne adresen: Rrugen "Beqir Luga", Nr.3, Tirane
Kapitali fillestar i Shoqerise eshte **100.000 leke**.

Administratori i Shoqerise do te jete **Z.AGRON PAPULI**.

Kohezgjatja e Shoqerise eshte mbi 15 vjet.

Kunder ketij vendimi mund te behete ankim ne Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

Anita Capo



**VENDIM
GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me date 27/9/2001 une Gjyqtar i Gjykates se Rrethit te Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi z. AGRON PECANI, administrator i shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k, i cili kerkon depozitimin e vendimit te asamblese se Jashtezakonshme te ortakeve dhe aktit noterial te transferimit te kuotave .

KONSTATOVA

Me vendimin nr. 25636 date 25.04.2001 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k.

Me vendim te Asamblese se Jashtezakondhme te ortakeve eshte vendosur miratimi per largimin nga shoqeria te Z.Arben Papuli dhe Z.Agron Papuli, pranimi i shoqerise "GURTEN" shpk me administrator Z.Agron Papuli, ortak se bashku me ortaket Shoqeria "MARO" sh.p.k , perfaqesuar nga administratori Z.MARSEL SKENDO, shoqeria "MEDIA 6 " sh a , me drejtor Z. ALEKSANDER FRANGAJ, Z. AGRON PECANI, Z. MITRUSH ÇUMASHI, Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke.Ndryshimin e administratorit dhe miratimi per largimin e Z. AGRON PAPULI ,dhe emerimin e Z.AGRON PECANI.

MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TE KUOTAVE :

1. Z. AGRON PAPULI per ne favor te SHOQERISE "GURTEN" shpk 25.5% me vlere 25.500 leke;
2. Z. ARBEN PAPULI per ne favor te shoqerise "MARO" shpk 21%% me vlere 21.000 leke dhe per ne favor te shoqerise "GURTEN" shpk me vlere me 4.500 lek
3. Z MITRUSH CUMASHI per ne favor te shoqerise "MARO " shpk 1% me vlere 1000 leke ;
4. Z.AGRON PECANI per ne favor te shoqerise "MEDIA 6 " sh a 1% me vlere 1000 leke ;

Me miratimin e vendimit te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve dhe transferimin e kuotave, shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" shpk, perbehet nga ortaket me kuota perkatese si me poshte:

Shoqeria "MARO" shpk zoteron kuoten 39% me vlere 39.000 leke

Shoqeria "GURTEN" shpk me administrator Z.. AGRON PAPULI zoteron kuoten 30% me vlere 30.000 leke;

Z. MITRUSH CUMASHI zoteron kuoten 11% me vlere 11000 leke;

Z. AGRON PECANI zoteron kuoten 11% me vlere 11000 leke;

Shoqeria "MEDIA 6 " sh a zoteron kuoten 9% me vlere 9000 leke.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar

PER KETO ARSYE
NE BAZE TE LIGJIT 7667 Dt.28.01.1993 dhe 7638 date 22.11.1992

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses se kerkuesit te shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" shpk me administrator z. AGRON PECANI, per depozitim ne rregjistrin tregtar te vendimit te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k dhe aktin noterial te transferimit te kuotave .

Urdherimin e zyles se rregjistrin tregtar te beje ndrydhimet ne kolonen perkatese, duke iu ndare rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim.

Tirane me 27/8/2001

GJYQTARI

A large, stylized handwritten signature in black ink, likely belonging to the judge mentioned in the text above.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. _____ VENDIMI

VENDIM

I GJYQTARES SE VETME

Sot me date ^{04/07}2004, Une gjyqtare Ariona Ceca e Gjykates Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e z.Agron Pecani me cilesine e administratorit te shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k:

KONSTATOVA

Shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr.25636 date 13.04.2001, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, me kapital themeltar 100.000 leke me kohezgjatje mbi 15 vjet , me objekt veprimtarie ne fushen: shtypshkronje per shtypjen e revistave, librave, gazetave, dhe botimeve te tjera te ndryshme si dhe import-eksport materialesh shtypi etj, ndryshuar me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr.25636/1 date 27.09.2001 ku administrator eshte emeruar z. Agron Pecani dhe ortake jane: shoqeria "Gurten" sh.p.k me 30% pjese te kapitalit perfaqesuar nga admnistratori z.Agron Papuli, shoqeria "Media 6" sh.p.k me 9% pjese te kapitalit perfaqesuar nga drejtori i shoqerise z.Aleksander Frangaj, shoqeria "Maro" sh.pk me 39% pjese te kapitalit perfaqesuar nga administratori z.Marsel Skendo, z.Agron Pecani me 11% pjese te kapitalit dhe z.Mitrush Cumashi me 11% pjese te kapitalit. Me vendimin Nr.2 date 28.05.2004 Asambleja e Ortakeve ne mbledhjen e jashtezakonshme te shoqerise ka vendosur:

1. Per arsye objektive te ndryshojme seline e shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k
2. Te ndryshoje Nenin Nr.1 te Statutit dhe te Aktit te Themelimit te shoqerise ne lidhje me seline e shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k

3. Selia e shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k nga Rr."Beqir Luga" Nr.3 ndryshohet ne Rr."Pandi Dardha" ish magazinat e ish N.Bujqesore "Gjergj Dimitrov" .
4. Selia e shoqerise do te jete: Rr."Pandi Dardha" ish magazinat e ish N.Bujqesore "Gjergj Dimitrov" .
5. Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Rregjistrimit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 " Per Rregjistrimin Tregtar "

VENDOSA:

- Pranimin e kerkeses.
 - Depozitimin e vendimit te Nr.2 date 28.05.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k.
 - Te behen ndryshimet perkatese ne Zyren e Rregjistrimit Tregtar ne kollonat respektive duke vijezimet me vije te kuqe.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE

Armando Ceko
Armando Ceko

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me date 21.12.2005, une gjyqtarja e Gjykes se Rrethit Gjyqesor Tirane, Ariana Caco, mora ne shqyrtim kerkesen dhe aktet e paraqitura nga kerkuesi Agron Pecani, administrator I shoqerise " SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " shpk dhe,

K O N S T A T O V A

Me vendimin nr. 25636 date 13.04.2001 të Gjykes se Shkalles se Pare Tirane, eshte regjistruar si person juridik shoqeria " SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " shpk , me kapital 100.000 leke dhe ortake te shoqerise :

1. Shoqeria " MARO " shpk, zoteruese e 39 % te kapitalit te shoqerise, me vlere 39.000 leke,
2. Shoqeria " GURTEN " shpk, zoteruese e 30 % te kapitalit te shoqerise, me vlere 30.000 leke,
3. Shoqeria " MEDIA 6 " sha, zoteruese e 9 % te kapitalit te shoqerise me vlere 9.000 leke,
4. Mitrush Cumashi zoterues i 11 % te kapitalit te shoqerise me vlere 11.000 leke,
5. Agron Pecani zoterues i 11 % te kapitalit te shoqerise me vlere 11.000 leke

Administrator Agron Pecani dhe seli ne Tirane.

Me vendimin nr. 1 date 17.06.2005 të Asamblese se Ortakeve te shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " shpk, me vendimin nr. 1 date 17.06.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "MARO " shpk, me vendimin nr. 1 date 17.06.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise " GURTEN " shpk dhe vendimin nr. 1 date 17.06.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise " MEDIA 6 " shpk eshte vendosur:

- Zmadhimi I kapitalit themeltar te nenshkruar te shoqerise " SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " shpk, nepermjet rezervave dhe fitimeve te pashperndara, gjendje ne daten 31.12.2004.
- Te caktoje znj. Margarita Gjergji, anetare e IKEA, me profesion Eksperte Kontabel e Autorizuar, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje te dates 31.12.2004.

- Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrir Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe ligjit 7667 date 28.01.1993.

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane Zyres se Regjistrir Tregtar te :

- Vendimit nr. 1 date 17.06.2005 të Asamblese se Ortakeve te shoqerise

“SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI“ shpk,

- Vendimit nr. 1 date 17.06.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise “MARO “ shpk,

- Vendimit nr. 1 date 17.06.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise “ GURTEN “ shpk dhe

- Vendimit nr. 1 date 17.06.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise “ MEDIA 6 “ shpk, sipas te cileve eshte vendosur :

- Zmadhimi I kapitalit themeltar te nenshkruar te shoqerise “ SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI “ shpk, nepermjet rezervave dhe fitimeve te pashperndara, gjendje ne daten 31.12.2004.

- Te caktoje znj. Margarita Gjergji, anetare e IKEA, me profesion Eksperte Kontabel e Autorizuar, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje te dates 31.12.2004.

- Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrir Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Urdherohet zyra e regjistrir tregtar te beje ndryshimet ne kollonat nr. _____, duke I ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E

Ariana CACO



URDHER - REGJISTRIMI

1 25636

2 (a) Emertimi: *Shtypshkronja e Ze Shkollor Jure, S.R.O.*

(b) Selia: *Zi' Beqir Duga, nr 3 Carrone.*

(c) Objekti: *Shtypshkronje për shtypjen e revistave, libere, gazeteve, etj.*

(ç) Kapitali: *100.000 lekë.*

3. Administrator i shoqërisë *Agim Populi*


4. Statuti është nënshkruar me dt. *06.04.2001.*

7.11.2001

5. Regjistruar me dt. *10.04.2001.*

Mandat Arketimi

Gjyqtare

Enver Cap


REPUBLIKA E SHQIPERISE



AKT-THEMELIMI

I

SHOQERISE "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI"

Shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" shpk eshte krijuar ne baze te Aktit te themelimit nga ortaket Arben Papuli, Agron Papuli, Mitrush Cumashi, Agron Pecani, Shoqeria Media 6" e perfaqesuar nga Aleksander Frangaj dhe nga shoqeria "MARO" shpk e perfaqesuar nga Marsel Skendo, sipas kerkesave te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

KREU 1
DISPOZITA TE PERGJITHSHME
NENI 1
EMERTIMI

Themelohet Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar « SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI » shpk

Me poshte, ne te gjitha rastet ku do te jete shkruar Shoqeria, duhet te lexohet Shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" SHPK

Selia zyrtare e shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes, Rr. Beqir Luga Nr.3.

Shoqeria pervec selise zyrtare te saj ne adresen si me siper, mund te hape filiale ose agjensi te ndryshme ne qytete te tjera apo edhe jashte shtetit.

NENI 2

Shoqeria gezon te gjitha te drejtat e personit juridik shqiptar qe nga dita e leshimit te autorizimit nga ana e organeve kompetente shqiptare.

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me kerkesat e legjislacionit shqiptar dhe me dispozitat qe jane parashikuar ne Aktin e themelimit dhe ne Statutin prezent.

NENI 3
OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se kesaj Shoqerie eshte hapja e nje shtypshkronje per shtypjen e revistave, librave, gazetave dhe botimeve te tjera te ndryshme, ngritja e nje shtepie botuese dhe shperndarese per librin dhe shtypin, si dhe import e eksport materialesh shtypi etj.

NENI 4
KOHEZJATJA

Shoqeria ka nje kohezgjatje prej per mbi 15 vjet, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykatën e rrethit Tirane si dhe ne organin tatimor.

Ky afat mund te zgjatet ose shkurtohet ne perputhje me kerkesat e ligjet se sipercituar dhe Statutit me Vendim te Asamblese se jashtezakonshme te ortakeve

NENI 5 KAPITALI THEMELOR

Kapitali themelor i Shoqerise eshte 100.000 Lek

Pjesmarrja ne kapitalin e Shoqerise eshte :

Arben Papuli 25.5% Agron Papuli 25.5%,Mitrush Cumashi 12% Agron Pecani 12%, Shoqeria "Media 6" shp' perfaqesuar nga Aleksander Frangaj 8% Shoqeria "MARO" shpk perfaqesuar nga Marsel Skendo 17 %

NENI 6 PERBERJA E KAPITALIT

Kapitali i shoqerise perbehet nga kontributet e Ortakut ne para dhe ne natyre, si dhe nga te gjitha mjetet e qarkullimit te nevojshme per veprimtarine e Shoqerise.

Likuiditetet dhe transaksionet financiare do te depozitohen dhe do te realizohen ne Banken ku do te hapet edhe llogaria rrjedhese, sipas mundesive te shoqerise ose edhe ne Banka te tjera shqiptare e te huaja.

NENI 7 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te Shoqerise caktohen nga Asamblea e Ortakeve.

NENI 8 NDARJA E FITIMIT

Fitimet neto te Shoqerise qe rezultojne nga bilanci, pasi te zbriten shumatat qe u perkasin detyrimeve ligjore, te fondit rezerve, te shpenzimeve te bera per administrim,amortizim,detyrime financiare, etj, me Vendim te Asamblese se Ortakeve, ndahet perpestimisht sipas kontributit perkates midis ortakeve.



NENI 9 MBROJTJA NGA SHTETI

Veprimtaria ekonomike e Shoqerise dhe investimet e ortakeve, qofte edhe te huaj,mbrohen nga shteti shqiptar, i cili u garanton atyre dhe vete Shoqerise, te nejtin trajtim dhe te njejtat te drejta, qe parashikon ligja.

NENI 10 SEKRETI

Ortaket jane te detyruar qe reciprokisht te ruajne sekretin lidhur me informatat dhe pervojen e akumuluar gjate veprimtarise se Shoqerise.

Ortaket jane pergjegjes per demet qe mund te rrjedhin nga mosrespektimi i detyrimeve te tilla.



NENI 11
ORGANET E SHOQERISE

Organet drejtuese te Shoqerise jane :

- a.Asamblea e Ortakeve
- b.Keshilli Administrativ dhe Administratori i vetem
- c.Eksperti kontabel i autorizuar dhe Komisioni i revizionimit

Administratori i shoqerise te jete Agron Papuli

NENI 12
DETYRAT E ORTAKEVE

Ortaket jane te detyruar te bashkepunojne per pergatitjen dhe fillimin e veprimtarise se Shoqerise per realizimin e objektivave te saj.

NENI 13

Ky Akt Themelimi hyn ne fuqi qe nga dita e firmosjes se tij nga Ortaket e Shoqerise.

NENI 14
MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet eventuale qe mund te lindin ndermjet ortakeve gjate veprimtarise se Shoqerise, midis tyre dhe Shoqerise, midis Shoqerise dhe organeve te tjera ose te tretet, normalisht zgjidhen ne mirekuptim. Ne te kundert kompetente eshte Gjykata e rrethit Tirane.

NENI 15

Dispozita te hollesishme per Shoqerine pershkruhen ne Statutin e saj.

NENI 16

Ky Akt Themelimi ka 16(gjashtembedhjete) nene

ORTAKET THEMELUES

Arben Papuli

Agron Papuli

Agron Pecani

Mitrush Cumashi

Shoqeria "Media 6" shp perfaqesuar nga Aleksander Frangaj

Shoqeria "MARO" shpk perfaqesuar nga Marsel Skendo

Tirane me 06.04.2001



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 1528 REP
Nr. 155

VERTETIM

Sot me date *06 Prill* 2001 (dymije e nje), ditën e *prezente*,
ne Dhomen e Noterise Tirane, para meje Noteres Shpresa
Kurti me seli ne rrugen e "Durrësit" mu paraqiten ortaket e
Shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" shpk: Shoqeria
"MARO" sh.p.k me administrator Z. Marsel Skendo, me seli ne
Tirane, rregjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane me vendim
Nr. 3258, date 29.03.1994; SHOQERIA "MEDIA 6" Sh.a me
rejtor Z. Aleksander Frangaj, regjistruar ne Gjykatën e
Rrethit Tirane me Vendimin Nr.16941 date 12.02.1997, AGRON
PECANI, i biri i Maqos, lindur ne 1951 ne Tirane e banues
po aty, Rr. Ali Demi, Nr.72, me leternjoftimi EV
Nr.213507, AGRON PAPULI, i biri i Sotirit, lindur ne 1955 ne
Tirane e banues po aty, Rr. Kongresi i Lushnjës, Nr,30, me
pashaporte Nr.1089545, MITRUSH CUMASHI, i biri i Vlashit,
lindur me 1944, banues ne Tirane, Rr. Naim Frasherit, Nr,84,
me pashaporte Nr.1253212, ARBEN PAPULI, i biri i
Sotirit, lindur ne Tirane me 1952, banues ne Tirane, rruga
"Durrësit", Nr.210, me pashaporte Nr.0596051. Te
lartpermendurit jane madhore, me zotesi te plote juridike, te
cilet me deklaruan se sa siper eshte nje Akt Themelimi i
Shoqerise i redaktuar jashte kesaj zyre dhe e neneshkruajne
me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne Zyren e
Noterise Tirane. Une Noterja e vertetimit rregullisht. _____

NOTERJE
Shpresa Kurti



STATUT

I

SHOQERISE "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" shpk

Shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" shpk, eshte krijuar ne baze te Aktit te themelimit nga ortaket Arben Papuli, Agron Papuli, Agron Pecani, Mitrush Cumashi, Shoqeria " Media 6"shq perfaqesuar nga Aleksander Frangaj dhe Shoqeria "MARO" perfaqesuar nga Marsel Skendo sipas kerkesave te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare",

Ortaket e Shoqerise hartojne Statutin si me poshte:

**KREU 1
DISPOZITA TE PERGJITHSHME
NENI 1
EMERTIMI**

Themelohet Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI"shpk

Me poshte, ne te gjitha rastet ku do te jete shkruar Shoqeria, duhet te lexohet Shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" SHPK

Selia zyrtare e shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranës , Rr. Beqir Luga, Nr.3.

Shoqeria, pervec selise zyrtare te saj ne adresen si me siper, mund te hape filiale ose agjensi te ndryshme ne qytete te tjera apo edhe jashte shtetit.

NENI 2

Shoqeria gezon te gjitha te drejtat e personit juridik shqiptar qe nga dita eleshimit te autorizimit nga ana e organeve kompetente shqiptare.

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me kerkesat e legjislacionit shqiptar dhe me dispozitat qe jane parashikuar ne Aktin e themelimit dhe ne Statutin prezent.

**NENI 3
OBJEKTI I SHOQERISE**

Objekti i veprimtarise se kesaj Shoqerie eshte hapja e nje shtypshkronje per shtypjen e revistave, librave, gazetave dhe botimeve te tjera te ndryshme, ngritja e nje shtepie botuese dhe shperndarese per librin dhe shtypin, si dhe import e eksport materialesh shtypi etj.

**NENI 4
KOHEZJATJA**

Shoqeria ka nje kohezgjatje prej per mbi 15 vjet, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykatën e rrethit Tirane si dhe ne organin tatimor.

Ky afat mund te zgjatet ose shkurtohet ne perputhje me kerkesat e ligjet se sipercituar dhe Statutit me Vendim te Asamblese se jashtezakonshme te ortakeve

NENI 5

PERGJEGJESIA

Shoqeria pergjigjet krejtesisht me pasurine e saj. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve dhe as keta te fundit, nuk detyrohen per humbjet e Shoqerise tej kuotave te derdhura per themelimin e Shoqerise.

Shoqeria gjithashtu nuk peregjigjet per detyrimin e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

NENI 6

KAPITALI THEMELOR

Kapitali themelor i Shoqerise eshte 100.000 Lek

Pjesmarrja ne kapitalin e Shoqerise eshte :

Arben Papuli 25.5% Agron Papuli 25.5%, Mitrush Cumashi 12% Agron Pecani 12%, Shoqeria "Media 6" shp perfaqesuar nga Aleksander Frangaj 8% Shoqeria "MARO" shpk perfaqesuar nga Marsel Skendo 17 %

NENI 7

PERBERJA E KAPITALIT

Kapitali i Shoqerise perbehet nga kontributet e ortakeve ne natyre ose ne para si dhe nga gjith mjetet qarkulluese te nevojshme per veprimtarine e Shoqerise.

Likuiditetet dhe transakcionet financiare do te depozitohen dhe do te mbeshteteten ne Banken ku do te hapet llogaria rrjedhese sipas mundesive te Shoqerise, ose edhe ne Bankat e tjera shqiptare e te huaja.

KREU 2

TE DREJTAT E DETYRAT E PALEVE

NENI 8

TE DREJTAT E ORTAKEVE


Palet kane te drejte te :

- marrin pjese ne administrimin e Shoqerise ne perputhje me aktin e themelimit .
- marrin pjese ne ndarjen e fitimeve.
- marrin pjese ne administrimit e Shoqerise me anen e perfaqesuesve te tyre prane organeve te Shoqerise.

NENI 9

Detyrimet e ortakeve jane :

- te bejne derdhje te kuotes se tyre ne kapitalin themelor te Shoqerise, sipas Statutit dhe Aktit te themelimit.



- te bejne derdhjen e kuotave suplementare sipas Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve dhe te Keshillit Administrativ ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutit.
- ti japin Shoqerise ndihmen e mevoneshme me qellim qe te arrihet cdo objektiv qe ka lidhje me Shoqerine dhe objektin e saj

NENI 10

DOREHEQJA NGA SHOQERIA

Cdo ortak gezon te drejten e doreheqjes nga Shoqeria, duke e motivuar vendimin e tij para Asamblese se jashtezakonshme.

Doreheqja eventuale muk e liron ortakun doreheqes nga detyrimet e tij te marra para shoqerise dhe nuk e liron ortakun doreheqes nga detyrimet e tij te marra para Asamblese se jashtezakonshme .

Doreheqja eventuale nuk e liron ortakun doreheqes nga detyrimet e tij te marra para shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e kesaj te fundit ndaj ortakut doreheqes .

KREU 3

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne baze te parimeve ekonomike dhe rezultatat pasqyrohen ne kontabilitet duke zbatuar parimet baze te kontabilitetit te parashikuara nga ligjislacionet shqiptar.

NENI 12

VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 13

SHPERNDARJA E SHOQERISE

Kur Shoqeria shperndahet, pasi zbriten shumat qe i perkasin pasivit . Shoqeria ndan mbetjet e kapitalit themeltar ndermjet ortakeve perpjestimisht me kuotat e tyre te derdhura per themelimin e Shoqerise, kur nuk ka patur mundesi per cedim.

NENI 14

PASURITE E SHOQERISE


Shoqeria krijon nje fond-pasuri te saj dhe eshte pronare e tyre.

NENI 15

FONDE REZERVE

Shoqeria krijon nje fond rezerve dhe fonde te tjera te posaçme, te nevojshme per zhvillimin e veprimtarise se Shoqerise. Perberja, shuma totale dhe burimet per krijimin e fondit rezerve si dhe perdorimi dhe administrimi i cdo fondi te posacem , percaktohet nga Administratori ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria mund te disponoje te gjitha mjetet financiare, si ato te sajat ashtu edhe kredite qe nevojiten per realizimin e qellimeve te Shoqerise.



NENI 16

FITIMI

Fitimi neto qe rezulton nga bilanci, pasi te jene zbritur shpenzimet e bera per administrim, amortizim, dhe detyrimet financiare, me Vendim te Asamblese se ortakeve, ndahen perpjestimisht me kuotat e secilit.

NENI 17

BILANCI

Bilancet vjetore mbyllen me date 31 dhjetor te cdo viti dhe duhet te paraqiten ne Asamblene e zakonshme te ortakeve per miratim brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

NENI 18

VEPRIMTARIA FINANCIARE

Veprimtarite financiare te Shoqerise realizohen sipas planeve ekonomiko financiare dhe programeve ekonomiko vjetore.

KREU 5

ADMINISTRIMI

NENI 19

ASAMBLEA

Organi kryesor vendimor i Shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve, ne te cilen secili ortak ka te drejte vote proporcionalisht me te drejte vote perpjestimisht me kuoten e kapitalit themelor, secili ortak.

NENI 20

ASAMBLEA E ZAKONSHME

Asamblea e zakonshme e ortakeve vendos :

- miratimin ose jo te bilancit vjetor
- emerimin, zevendesimin dhe shperblimin e administratoreve ose drejtuesve te tjere te Shoqerise
- emerimin, zevendesimin dhe shperblimin e ekspertit kontabel te autorizuar.
- direktivat strategjike per veprimtarine e Shoqerise.


NENI 21

ASAMBLEA E JASHTEZAKONSHME

Asamblea e jashtezakonshme e ortakeve vendos:

- ndryshimet ne Statut dhe Aktin e themelimit
- shtimin ose pakesimin e kapitalit themelor te Shoqerise
- zgjatjen ose pakesimin e kohezgjatjes se veprimtarise se Shoqerise.
- pushimin e veprimtarise se Shoqerise
- cedimin e kuotave te kapitalit themelor, te treteve
- transformimin e Shoqerise ne forma te tjera shoqerish

Asamblea e jashtezakonshme e ortakeve duhet te mblidhet ne territorin e Republikes se Shqiperise.



NENI 22

Vendimet e Asamblese se zakoneshme dhe te jashtezakoneshme ne perputhje me ligjislacionin shqiptar, jane te detyrueshme per te gjitha ortaket perfshire ketu edhe ata qe nuk kane qene te pranishem ose qe kane votuar.

NENI 23

ADMINISTRIMI I SHOQERISE (KOMPETENCAT)

Keshilli administrativ, administratoret, administrojne shoqerine duke u emeruar per tre vjet me te drejten e rizgjedhjes nga ana e Asamblese se Ortakeve.

Administrator i Shoqerise do te jete Agron Papuli me te gjitha pushtetet qe i jep ligja.

NENI 24

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Organi administrativ i Shoqerise perfaqesohet nga administratoret e saj, te cilet emerohen dhe konfirmohen ne detyren e tyre nga Asamblea e ortakeve, sipas propozimit te ortakeve.

Administratorit i njihen te gjitha kompetencat per administrimin e Shoqerise.

Administratori eshte pergjegjes personalisht kundrejt Shoqerise dhe te treteve per mosrespektim e zbatim te legjislacionit , aktit te themelimit, statutit si dhe per veprime te kryera me faj gjate ushtrimit te veprimtarise se tij.


Kompetencat eskuzive te administratorit jane:

- Te organizoje veprimtarine e Shoqerise me qellim qe te realizohen te gjitha programet e saja.
- Te siguroje administrimin e Shoqerise.
- Te administroje dhe drejtoje pasurine dhe mjetet financiare te Shoqerise brenda limiteve te lejuara nga Asamblea e ortakeve.
- Te perfaqesoje Shoqerine ne marredhenie me te tretet brenda caqeve te objektit te Shoqerise me perjashtim te ceshtjeve qe ligji Akti i themelimit dhe ky Statut i le ne kompetence te Asamblese se ortakeve.
- Te perfaqsoje Shoqerine para autoriteteve gjyqesore, arbitrare e administrative.
- Te drejtoje e kontrolloje veprimtarine e filialeve e agjencive te Shoqerise.
- Te leshoje prokure te posacme per funksionare te Shoqerise dhe per te trete, por detyrimisht keto prokura duhet te mos kalojne caqet e kompetencave te te tij.

Ne te gjitha rastet Administratori vepron brenda kufijve te kompetencave te tij.

NENI 25

Veprimtaria operative e Shoqerise mund te drejtohet edhe nga nje drejtor i pergjithshem qe emerohet ose caktohet nga Administratori i vetem, por gjithmone me miratim te Asamblese se ortakeve.



Kompetencat e drejtorit te pergjithshem caktohen nga Administratori, por gjithmone brenda kufijve te percaktuara nga Akti i themelimit dhe Statuti, kur behet fjale per kompetencat e Administratorit .

NENI 26

KONTOLLI PER ADMINISTRIMIN E SHOQERISE

Per te kontroluar veprimtarine financiare te Shoqerise dhe te filialeve, agjencive apo zyrave te saj, emerohet nje ekspert kontabel i autorizuar.

NENI 27

TRANSFORMIMI I SHOQERISE

Transformimi i Shoqerise nga SHPK ne forma te tjera shoqerish behet me miratim unanim te ortakeve.

NENI 28

MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ne Shoqeri, ne filialet, agjencite apo zyrat e seksionet e saj, rregullohen me kontraten e punes. Shoqeria ka te drejte te punesoje magaziniere, manaxhere, juriste, perkthyes, specialiste te fushave te ndryshme, ekonomiste, etj.

Per te gjitha ceshtjet qe nuk permenden ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat sipas Kodit te punes. Ne shoqerine per ndertimin do te punesohet nje specialist i licencuar ndertimi.

KREU 6

PUSHIMI I VEPRIMTARISE

NENI 29

PUSHIMI

Veprimtaria e Shoqerise pushon me mbarimin e afatit te caktuar ne Aktin e Themelimit, me perjashtim te rasteve kur ky afat shtyhet.

Shoqeria mund te pushoje veprimtarine e saj para afatit, me kerkese dhe me Vendim te Asamblese se jashtezakonshme te ortakeve, ose ne raste te parashikuara ne Aktin e Themelimit dhe Statut.

NENI 30

SHPERNDARJA

Shoqeria shperndahet :


- a. Me mbarimin e afatit te kohezjatjes se saj
- b. Ne rast se nuk ka mundesi te realizohet objekti i saj
- c. Me miratimin unanim te te gjithë ortakeve

NENI 31

LIKUIDIMI

Likuidimi i Shoqerise behet sipas rregullavete parashikuara ne Ligjin « Per Shoqerite tregtare ».

Kur shperndahet Shoqeria:



- Asambleja e Jashtezakoneshem emeron likuidatorin.
- Pasuria dhe mjetet e vena ne dispozicion te Shoqerise dhe filialeve si dhe fondet financiare ndahen midis ortakeve perpjestimisht me kapitalin qe posedojne secili ortak, pasi te jene paguar te gjitha pasivitetet dhe shpenzimet.

NENI 32

Kur pushon veprimtaria e nje filiali per shkak te vete saj afati i mbylljes percaktohet nga Administratoret e Shoqerise.

NENI 33

MOSMARREVESHJET DHE LIGJI I ZBATUESHEM

Mosmarreveshjet qe eventualisht mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise midis ortakeve ose midis tyre dhe Shoqerise si dhe organet kompetente zgjidhen ne mirekuptim midis paleve. Ne te kundert, kopetente eshte Gjykata e Tiranës.

NENI 34

Ky statut ka 34 (tridhjetë e kater) nene.

ORTAKET THEMELUES

Arben Papuli

Agron Papuli

Agron Pecani

Mitrush Cumashi

Shoqeria "Media 6" shp perfaqesuar nga Aleksander Frangaj

Shoqeria "MARO" shpk perfaqesuar nga Marsel Skendo

Tirane me 06.04.2001



(Handwritten signatures of the founders: Arben Papuli, Agron Papuli, Agron Pecani, Mitrush Cumashi, Aleksander Frangaj, and Marsel Skendo)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 1529 REP
Nr. 156 vol

VERTETIM

Sot me date 06. Prill 2001 (dymije e nje), ditën e *primitë*, ne Dhomen e Noterise Tirane, para meje Noteres Shpresa Kurti me seli ne rrugen e "Durrësit" mu paraqiten ortaket e Shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" shpk: Shoqeria "MARO" sh.p.k me administrator Z. Marsel Skendo, me seli ne Tirane, rregjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane me vendim Nr.3258, date 29.03.1994; SHOQERIA "MEDIA 6" Sh.a me Drejtor Z. Aleksander Frangaj, regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane me Vendimin Nr.16941 date 12.02.1997, AGRON PAPANI, i biri i Maqos, lindur ne 1951 ne Tirane e banues po aty, Rr. Ali Demi, Nr.72, me leternjoftimi EV Nr.213507, AGRON PAPULI, i biri i Sotirit, lindur ne 1955 ne Tirane e banues po aty, Rr. Kongresi i Lushnjes, Nr,30, me pashaporte Nr.1089545, MITRUSH CUMASHI, i biri i Vlashit, lindur me 1944, banues ne Tirane, Rr. Naim Frasherit, Nr,84, me pashaporte Nr.1253212, ARBEN PAPULI, i biri i Sotirit, lindur ne Tirane me 1952, banues ne Tirane, rruga "Durrësit", Nr.210, me pashaporte Nr.0596051. Te lartpermendurit jane madhore, me zotesi te plote juridike, te cilet me deklaruan se sa siper eshte nje STATUT i Shoqerise i redaktuar jashte kesaj zyre dhe e neneshkruajne me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne Zyren e Noterise Tirane. Une Noterja e vertetoj rregullisht. _____

NOTE RE
Shpresa Kurti

PULLE TAKSE



RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



RISHQIPERISE

Zy A Cepo
10.04.2001
10. APR. 2001

SHOQERIA "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" SH.P.K

KERKESE

KERKUESI: Shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k, perfaqesuar nga administratori Agron Papuli, me seli ne Tirane, Rr "Beqir Luga", Nr.3, me leternjoftimi 1089545.

OBJEKT: Kerkohet regjistrimi i shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k person juridik, ne baze te Ligjit Nr. 7638 "Per shoqerite Tregtare" dt.19.11.1992 dhe Ligjit Nr.7667 dt.28.01.1993 "PER REGJISTRIN TREGTAR".

Gjykates se Rrethit Tirane
(Regjistrit Tregtar)

Ne baze te aktit te themelimit eshte krijuar shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" sh.p.k, me ortaket Shoqeria "MARO" shpk me administrator Z.Marsel Skendo, Shoqeria "MEDIA 6" sha me administrator Aleksander Frangaj, ARBEN PAOULI, AGRON PAPULI, AGRON PECANI dhe MITRUSH CUMASHI me seli ne Tirane, Rr. "Beqir Luga", Nr.3, me kapital 100 000 Lek, te ndara : ARBEN PAPULI 25.5% me vlere 25.500 leke, AGRON PAPULI 25.5% me vlere 25.500 leke, MITRUSH CUMASHI me 12% me vlere 12.000 leke, AGRON PECANI 12% me vlere 12.000 leke, SHOQERIA "MEDIA 6" shpk me 8% me vlere 8000 leke dhe Shoqeria "MARO" shpk me 17% me vlere 17.000 leke, A. me kohëzgjatje mbi 15 vjet. Objekti i shoqerise: shtypshkronje per shtypjen e revistave, librave, gazetave dhe botimeve te tjera te ndryshme, si dhe import e eksport materiale shypjetj. ADMINISTRATORI i Shoqerise eshte AGRON PAPULI.

Ne keto rrethana redaktohet kjo kerkese qe si u lexua dhe u gjet me vullnetin e lire u neneshkrua.

PULLE TAKSE



RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



RISHQIPERISE


KERKUESI

**ADMINISTRATORI
AGRON PAPULI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR.1539REP**

VERTETIM

Sot me date *06 Prill* 2001 (dymijee nje), ditën e *preunte*, ne Dhomen e Noterise Tirane, para meje Noteres Shpresa Kurti me seli ne frugen e "Durrësit" mu paraqit: SHOQERIA "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" shpk me administrator AGRON PAPULI, me pashaporte Nr.1089545, madhor me zotesi te plote juridike, i cilideklaroi se sa siper eshte nje kerkese per regjistrimin e Shoqerise prane Gjykates se Rrethit Tirane, e reaktuar jashte kesaj zyre dhe e nenshkroi sa siper me vullnetin e tij te lire dhe te plote. Une noterja e vertetoi rregullisht.



NOTERE

SHOQERIA "MARO" Sh.p.k.

VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONESHME TE ORTAKEVE TE
SHOQERISE

Sot me dt. 6.4.2001 ne ortaket e Shoqerise "MARO" Sh.p.k. Julien ROCHE e Marsel SKENDO, qe eshte njekohesisht edhe Administrator i kesaj Shoqerie, morrem ne shqyrtim themelimin e Shoqerise " SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " Sh.p.k.si dhe delegimin e Z. Marsel SKENDO qe te miratoje dhe te nenshkruaje Statutin dhe Aktin e Themelimit te kesaj Shoqerie.

Shoqeria jone " MARO " Sh.p.k., e themeluar dhe e regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 3258, dt 29.3.1994, merr pjese si ortak ne Shoqerine " SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " Sh.p.k. se bashku me ortaket Arben PAPULI, Agron PAPULI, Mitrush CUMASHI, Agron PECANI dhe Shoqerine "MEDIA 6" Sh.a., te perfaqesuar nga Drejtori i saj Aleksander FRANGAJ.

Kontributet ne para ne Kapitalin Themeltar jane si me poshte:

Shuma e Kapitalit Themeltar 100.000 leke nga te cilat:

Z. Arben PAPULI me 25.500 leke ose 25,5 %;

Z. Agron PAPULI me 25.500 leke ose 25,5 %;

Z. Mitrush CUMASHI me 12.000 leke ose 12 %;

Z. Agron PECANI me 12.000 leke ose 12 %;

Shoqeria " MARO " Sh.p.k. me 17.000 leke ose 17 %;

Shoqeria " MEDIA 6 " Sh.a. me 8.000 leke ose 8 %..

Administratori I Shoqerise " SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " Sh.p.k. do te jete Agron PAPULI.


Mbas diskutimeve,

VENDOSEM


Jemi dakord qe te themelohet Shoqeria " SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " Sh.p.k. me te dhenat e mesiperme dhe qe Administratori i Shoqerise sone " MARO " Sh.p.k. te miratoje e te nenshkruaje Statutin dhe Aktin e Themelimit te kesaj Shoqerie. Sa siper, mbasi u lexua, u nenshkrua me vullnetin e lire te Aksionereve.

ORTAKET

Marsel SKENDO



Julien ROCHE





SHOQERIA "MEDIA 6" Sh.a.

VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONESHME TE AKSIONEREVE TE SHOQERISE

Sot me dt. 6.4.2001 ne aksioneret e Shoqerise "MEDIA 6" Sh.a. Marsel SKENDO, Julien ROCHE dhe Aleksander FRANGAJ, qe eshte njekohesisht edhe Drejtor i kesaj Shoqerie, morrem ne shqyrtim themelimin e Shoqerise "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" " Sh.p.k.si dhe delegimin e Z. Aleksander FRANGAJ qe te miratoje dhe te nenshkruaje Statutin dhe Aktin e Themelimit te kesaj Shoqerie.

Shoqeria jone " MEDIA 6 " Sh.a., e themeluar dhe e regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 1694 / 3, dt 10.5.2000, merr pjese si ortak ne Shoqerine " SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " Sh.p.k. se bashku me ortaket Arben PAPULI, Agron PAPULI, Mitrush CUMASHI, Agron PECANI dhe Shoqerine "MARO" Sh.p.k., te perfaqesuar nga Administratori i saj Marsel SKENDO.

Kontributet ne para ne Kapitalin Themeltar jane si me poshte:

Shuma e Kapitalit Themeltar 100.000 leke nga te cilat:

Z. Arben PAPULI me 25.500 leke ose 25,5 %;

Z. Agron PAPULI me 25.500 leke ose 25,5 %;

Z. Mitrush CUMASHI me 12.000 leke ose 12 %;

Z. Agron PECANI me 12.000 leke ose 12 %;

Shoqeria " MARO " Sh.p.k. me 17.000 leke ose 17 %;

Shoqeria " MEDIA 6 " Sh.a.. me 8.000 leke ose 8 %..

Administratori i Shoqerise " SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " Sh.p.k. do te jete Agron PAPULI.

Mbas diskutimeve,

VENDOSEM

Jemi dakord qe te themelohet Shoqeria " SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI " Sh.p.k. me te dhenat e mesiperme dhe qe Drejtori i Shoqerise sone " MEDIA 6 " Sh.a. te miratoje e te nenshkruaje Statutin dhe Aktin e Themelimit te kesaj Shoqerie. Sa siper, mbasi u lexua, u nenshkrua me vullnetin e lire te Aksionereve.

AKSIONERET

Marsel SKENDO

Julien ROCHE

Aleksander FRANGAJ

25636/1

22.09.2001



3 A xhoxhoj
11.09.2001
[Signature]

SHOQERIA "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" SH.P.K

K E R K E S E

KERKUESI: Shoqeria "SHTYPSHKRONJA E RE MIHAL DURI" SH.P.K rregjistruar si Person Juridik me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr 25636 date 25.04.2000, me seli ne Tirane, me adminitrator Z.AGRON PECANI.

